



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2018 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

**Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe
Shëndetësinë**

Rendi i ditës:

Mbledhje e përbashkët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për shqyrtimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.04.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar”. Votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Blerina Gjylameti, Adelina Rista, Arben Kamami, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Milva Ekonomi, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Besnik Baraj(zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues), Klotilda Bushka dhe anëtarë të grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve”: Vasilika Hysi, Antoneta Dhima, Evis Kushi.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Fidel Ylli, Roland Xhelilaj, Vangjel Tavo, Florda Kërpaçi, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Albana Vokshi, Musa Ulqini, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Endri Hasa.

Të ftuar:

Erion Braçe – deputet i Kuvendit të Shqipërisë, propozues i projektligjit.

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Përshëndetje të gjithëve!

Sot zhvillohet një mbledhje e përbashkët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për shqyrtimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.04.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar””.

Në këtë mbledhje të ftuar janë anëtarët e grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve” dhe zoti Braçe, i cili është edhe propozuesi i kësaj nisme të shkëlqyer, në opinionin tim. Ky projektligj që ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i pijeve energjike dhe pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar, duke ndaluar përdorimin e pijeve energjike dhe kufizuar marketingun si të pijeve energjike, ashtu edhe të pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

Fjalën ia jap zotit Braçe për të prezantuar më në detaj ndryshimet në këtë projektligj dhe pastaj mund të bëjmë pyetje dhe diskutime.

Erion Braçe – Të nderuara zonja,

E nderuar drejtuese e dy komisioneve respektive,

Të nderuar kolegë,

Është hera e parë që ndodhem në një pozitë të tillë për të prezantuar një projektligj, në këndvështrimin tim, i lidhur drejtpërdrejt me interesin publik dhe, më ngushtë, me interesin e fëmijëve. Duhet të jesh prind i një fëmijëve në moshë të tillë për të kuptuar angazhimin që duhet të ketë gjithësecili në një çështje me fokus fëmijët.

Trajtimi i çështjes së pijeve energjike ka qenë një fokus i posaçëm gjatë pesë vjetëve të fundit. Bashkë me kolegët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit menduam që në krye të herës të ngarkonim nga pikëpamja fiskale produktin dhe, natyrisht, edhe tregtimin e këtij produkti. E ngarkuam me një akcizë, por më duhet ta pranoj, ashtu siç e kam pranuar edhe gjatë shqyrtimeve të vazhdueshme në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, që dëshira jonë për të frenuar konsumin e pijeve energjike për një mori efektesh që ato kanë, për të cilat do të flas më poshtë, në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk pati sukses. Konsumi i pijeve energjike, pavarësisht akcizës së vendosur mbi to, pati rritje domethënëse me 13-14% të volumit të konsumit në vit.

Ky projektligj, që modestish po e prezantoj, ka marrë shkas nga një iniciativë e mëparshme dhe nga vullneti i të gjithë kolegëve të mi në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për ta shtyrë më tej iniciativën në një model të ri, që është modeli i kufizimit të

përdorimit, tregtimit dhe marketingut të këtyre pijeve te fëmijët. Kjo na shtyu të gjithëve bashkë që të konsultohemi edhe me një grup njerëzish profesionistë të fushës së shëndetit publik, mes të cilëve dua të veçoj një ish-koleg deputet, por njëherësh edhe mjek, doktor Eltar Dedën, i cili ka dhënë një pjesë të rëndësishme të kontributit të tij në analizën që i është bërë këtij fenomeni, por edhe të draftimit të neneve respektive që vendosin këto kufizime.

Qëllimi i këtij projektligji dhe objektivat që duam të arrijmë kanë të bëjnë drejtpërdrejt me parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, duke ndaluar përdorimin e pijeve energjike dhe kufizuar marketingun si të pijeve energjike, ashtu dhe të pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar nga të miturit.

Gjatë viteve të fundit ka modele që dëshmojnë në mënyrë të qartë, që nga Europa dhe më gjerë, që vendet janë përfshirë në një përpjekje për të kufizuar konsumin e pijeve energjike, përmes tyre kufizimin e kafeinës dhe substancave sintetike, si dhe pijeve të gazuara me sheqer të shtuar. Konsumi i pijeve me kafeinë, që japin energji të shtuar tek ata që i konsumojnë, është rritur ndjeshëm gjatë 10 vjetëve të fundit. Pak më parë e theksova që në harkun e 5 vjetëve të fundit ne, si Komision i Ekonomisë dhe Financave, kemi pasur në fokus për ta ngarkuar me një barrë fiskale të rëndë, përtej produkteve të tjera, natyrisht që ka njohur rritje.

Sipas studimeve, pijet energjike përbejnë 20% të produkteve ushqimore që gjenden sot në treg. Me rritjen e pranisë së tyre në treg, po aq i lartë është edhe rreziku toksik nga taurina ose mbidoza nga kafeina. Megjithëse mungojnë të dhënat e hollësishme, pra nuk ka institucione që të merren në mënyrë specifike me këtë çështje, për nivelet e konsumit nga të miturit të pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar dhe pijeve energjike për vendin tonë ekzistojnë raporte të publikuara nga Instituti i Shëndetit Publik që tregojnë të dhëna, në gjykimin tonë, alarmante.

Kështu, në raportin e fundit të publikuar nga ky institut “Iniciativa e survejancës së obezitetit në moshën feminare, rezultatet e vitit 2016”, ku u analizua tendenca e mbipeshës dhe obezitetit midis fëmijëve shqiptarë të moshës 8 deri në 9 vjeç, u vërejtën karakteristika mjedisore lidhur me ushqyerjen dhe aktivitetin fizik të fëmijëve në mjediset shkollore dhe treguesit mbi konsumin e ushqimeve dhe pijeve te fëmijët, si dhe shkallës së aktivitetit të tyre fizik. Për analizën e rezultateve të studimit të obezitetit të fëmijëve të moshës 8 deri në 9 vjeç u përzgjedhën mbi 3500 fëmijë nga 125 shkolla të arsimit 9-vjeçar në disa rrethe të vendit. Nga të dhënat e raportit rezultonte se gati 40% e fëmijëve konsumonin pije freskuese me sheqer më pak se një herë në javë; 26% disa ditë, 1 deri në 3 ditë; 7%, 4 deri në 6 ditë në javë dhe 6,4% çdo javë. Ajo çfarë është më shqetësuese në raport është se, edhe pse 86,4% e shkollave të

survejuara raportonin se zhvillonin si pjesë të kurrikulës se tyre mësimore edukimin mbi ushqyerjen, nga ana tjetër, lejonin tregtimin brenda mjediseve të shkollës si të pijeve energjike, ashtu edhe të pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar.

Për sa u përket pijeve energjike, zakonisht ato janë joalkoolike, që përmbajnë nivele të larta të kafeinës dhe sheqerit në kombinim me përbërës të tjerë të njohur për vetitë stimuluese. Ato tregtohen në mënyrë eksplicite, si një mënyrë për të lehtësuar lodhjen, siç ju e keni parë “për të fluturuar me krahë”, dhe për të përmirësuar vigjilencën mendore. Është e rëndësishme që këto pije të dallohen nga të tjerat, që përdoren për aktivitete sportive, të cilat përbëhen kryesisht nga karbohidratet dhe elektrolitet dhe janë të destinuara për të ndihmuar atletët që të hidratohen pas aktivitetit sportiv.

Përbërësit kryesorë të pijeve energjike janë: taurina, kafeina, ekstrakti i guaranës dhe xhinsengu. Këtij lëngu, që premtonte energji të shpejtë, i shtohen aminoacide, vitamina dhe karbohidrate, për ta shitur si një pijë që tek-tuk ka edhe vlera ushqyese. Prodhuesit e këtyre pijeve energjike shenjestrojnë atletët, studentët dhe njerëzit, profesioni i të cilëve kërkon njëfarë përqendrimi dhe vigjilence. Dëshmitë që vijnë janë pothuajse nga një pjesë e konsiderueshme e botës, duke filluar nga Europa, dhe tregojnë se konsumimi i pijeve energjike nga fëmijët dhe adoleshentët është i lidhur ngushtë me tri grupe sjelljeje të rrezikshme: përdorimi i alkoolit, pirja e duhanit ose ndjeshmëria ndaj pirjes së duhanit, si dhe përdorimi i drogave ilegale.

Gjithashtu, ekzistojnë disa dëshmi se konsumatorët e kategorisë së të rinjve kanë më shumë gjasa të kenë dieta jo të shëndetshme dhe të përjetojnë hiperaktivitet dhe një sërë efektesh të tjera shëndetësore.

Mjaftojnë kaq për të thënë se përdorimi i këtyre pijeve, veçanërisht nga të miturit dhe posaçërisht për moshën 15 deri në 18 vjeç, që është edhe targeti i marketingut të tyre, mund të krijojë probleme të shtuara për organizmin e tyre. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi synuar ndalimin e konsumit të pijeve energjike pikërisht për fëmijët deri në moshën 18 vjeç. Problemi agravohet edhe më tepër kur ka dëshmi të qarta të kombinimit të pijeve energjike me alkoolin, veçanërisht në klube të posaçme deri te klubet e natës, duke prodhuar një bombë toksike për organizmin e këtyre të rinjve apo edhe të miturve, që ndodh nëpër festa, të cilat organizohen rëndom në territorin këtij vendi.

E njëjta problematikë, si në rastin të pijeve energjike, ka të bëjë edhe me pijet me sheqer të shtuar. Para se të flas për këtë, dua të theksoj me forcë se nga studimet e bëra nga një sërë institutesh të shëndetit publik si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë vendit, janë 14 rreziqe që vijnë nga konsumi i pijeve energjike, veçanërisht për këtë moshë.

1. Arresti kardiak,

Studimet tregojnë se pijet energjike shkaktojnë kontraktime të forta të zemrës, të cilat mund të jenë të dëmshme për disa individë me probleme të zemrës. Studimet tregojnë se ndërmjet viteve 2009-2011 në qendrat e kontrollit toksik rezultuan mbi 4854 telefonata në linjat e emergjencave në lidhje me pije energjike. 51% e këtyre telefonatave përfshinin fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.

2. Dhimbje koke dhe migrenë.

Shumë pije energjike mund të çojnë në dhimbje koke të rënda nga simptomat e mungesës së kafeinës, e cila merret vazhdimisht nëpërmjet konsumit të tyre. Ndryshimi i sasisë së kafeinës që konsumohet çdo ditë mund të shkaktojë dhimbje koke të shpeshta.

3. Rritja e ankthit.

Individët me 2 variacione të ndryshme gjenetike në receptorët e tyre të adenosinës janë të pritur të ndiejnë ankth të rritur, kur konsumojnë pije me përmbajtje kafeine si pije energjike. Doza më të mëdha të kafeinës mund të nxisin, madje, edhe atake paniku të rënda.

4. Pagjumësia.

Pijet energjike bëjnë një punë të mirë për t'i mbajtur njerëzit të zgjuar, por kur abuzohet, mund të bëjnë që disa njerëz ta humbasin fare gjumin.

5. Diabeti i tipit 2.

Për shkak se shumë pije energjike kanë, gjithashtu, doza shumë të larta të sheqerit, ato eventualisht mund të dëmtojnë qelizat që prodhojnë insulinën e pankreasit, gjë që çon në diabetin e tipit 2.

6. Ndërveprimi me medikamente.

Disa nga përbërësit në pije energjike mund të ndërveprojnë me medikamente me recetë, sidomos medikamente të marra për depresion.

7. Varësia.

Njerëzit mund të bëhen të varur plotësisht nga kafeina dhe pijet energjike.

8. Sjellja e rrezikshme.

Ka një studim, që ne e kemi hasur gjatë punës për të draftuar këtë projektligj, i cili tregoi se adoleshentët kanë më shumë gjasa të kryejnë veprime të rrezikshme kur konsumojnë sasi të larta kafeine, duke kaluar në euforinë që pason vazhdimisht konsumimin e tyre.

9. Çrregullime dhe nervozizëm.

Sasia e lartë e kafeinës, si pasojë e konsumit të ekzagjeruar të pijeve energjike, shkakton ankth, dridhje, marramendje e të tjerë. Kjo mund të ndërhyjë në kryerjen e detyrave të nevojshme ose të shkaktojë probleme të rënda emocionale.

10. Të vjella.

Shumë pije energjike mund të çojnë në të vjella. Kjo shkakton dehidratim dhe erozion acid jo vetëm të dhëmbëve, por edhe të ezofagut, nëse konsumimi është i shpeshtë.

11. Reagime alergjike.

12. Presion i lartë i gjakut.

Produktet e kafeinuara, si pijet energjike, mund të rrisin presionin e gjakut te një person. Për individët me presion normal të gjakut kjo nuk është shqetësuese, por tek ata me presion të lartë të gjakut, nëse konsumojnë shumë pijë energjike për një periudhë të shkurtër kohore, mund të vendosin veten në rrezik për probleme të tjera shëndetësore, që lidhen me hipertensionin.

13. Overdoza e niacinës.

Kjo është vendosur në shumicën e pijeve energjike në nivele që nuk shkaktojnë dëm dhe mund të jenë edhe terapeutike. Megjithatë, nëse një person merr suplemente ushqimore që përmbajnë niacin, mbidozimi me vitaminë mund të shkaktojë simptoma që përfshijnë marramendje, rrahje të shpejtë të zemrës, të vjella e të tjera si këto.

14. Lirimi i Hormonit të Stresit.

Ky studim, që ne e administruam gjatë procesit të draftimit të ligjit, dëshmon se një version i një pijeje energjike shkakton rritje të nivelit mesatar të norepinefrinës te konsumatorët me 74% të saj.

Për të gjitha këto risqe, një pjesë e pijeve energjike që tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë janë prodhime të pacertifikuara, me origjinë ose pa origjinë të shpallur europiane, shiten në bidonë plastikë në sasi të mëdha dhe i gjeni kudo, veçanërisht në zonat rurale, por në krahun tjetër ka vazhdimisht promocion për të nxitur konsumin e tyre. Fjala vjen, sot, në supermarketet e lagjeve apo edhe më gjerë, mund të blesh dy të tilla me vlerën e njëjës, si promocion që këto rrjete tregtare ofrojnë për konsumin e pijeve energjike.

Gjatë kohës që po draftonim projektligjin, na erdhi në ndihmë jashtë mase iniciativa e qeverisë britanike në raport me këtë gjë. Dua ta theksoj këtë pjesë, sepse kemi parë që Britania kishte deri në këtë moment një instrument vetërregullimi. Vetë rrjetet e tregtimit në Britani kishin vendosur që të mos lejonin tregtimin e këtyre produkteve për fëmijët, por, pavarësisht këtij vetërregullimi, që në Shqipëri nuk ndodh, ...

Ju thashë, shembulli tipik në Shqipëri për të rritur konsumin e pijeve energjike është promocioni: merr dy, paguaj një. Shifrat e konsumit që ne i kemi administruar vit për vit në Komisionin e Ekonomisë për efekt të barrës fiskale tregojnë pikërisht këtë gjë. Në këtë vend, në ndryshim nga ajo që bëhet apo që më së shumti zë vend në të gjithë Europën, si përgjegjësi

sociale e atyre që merren me tregtimin e këtyre produkteve, kontrasti është shumë i thellë. Pikërisht për këtë arsye edhe Britania ka kaluar nga faza e vetërregullimit në një fazë të qartë të sanksionimit me ligj të ndalimit të konsumit të pijeve energjike për fëmijët, të tregtimit dhe promocionit të tyre. Debati atje ka qenë për moshën dhe, me sa kam mësuar së fundmi, po shkohet drejt definimit me ligj të ndalimit të konsumit të pijeve energjike deri në moshën 18 vjeç. Kjo na shtyu që edhe ne të bënim thuajse të njëjtat definicione në draftligjin që kemi.

Ndërkohë, ju thashë pak më parë që pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, janë problemi i dytë i madh për sa i përket shëndetit të fëmijëve. Studimet e Institutit të Shëndetit Publik e bëjnë të qartë faktin që këto pije, jo vetëm konsumohen në ambiente ngjitur apo edhe brenda shkollave, por në krahun tjetër, edhe familjet kanë qenë shumë të hapura për të përmbushur dëshirat e fëmijëve të tyre për konsumin e këtyre pijeve, që në një farë mase konsiderohen të pëlqyeshme nga fëmijët si dhurata apo edhe nga dëshira insistuese. Kjo e nxitur në mënyrë të qartë nga marketingu dhe promocioni shumë agresiv në cilëndo media dhe në cilindo ambient, përfshirë edhe ato shkollore, për konsumin e pijeve me gaz me sheqer të shtuar.

Për këtë kategori ne kemi propozuar kufizim të marketingut, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve të vegjël, të mitur dhe ku pasojat e konsumit të pijeve me sheqer të shtuar janë më të dukshme, më të prekshme dhe më të ndjeshme. Po t'i shikosh nga pikëpamja vizuale, fëmijët që konsumojnë përtej çdo caku produkte të tilla, janë obezë që në pamje të parë, jo më t'u nënshtrohen edhe analizave.

Ne i kemi propozuar ndryshimet jo pa qëllim në ligjin "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit". Të tria kufizimet që bëhen në këtë ligj për alkoolin, pijet energjike dhe pijet me gaz me sheqer të shtuar janë të së njëjtës natyrë dhe kanë të njëjtin qëllim: të mbrojnë të miturit dhe veçanërisht adoleshentët nga konsumi i këtyre pijeve. Pra, natyra e parë e ndryshimit të këtyre neneve ka të bëjë me shtimin e kufizimit të pijeve energjike në gamën e kufizimeve që parashikon ligji aktual për përdorimin e alkoolit dhe, së dyti, kanë aspektin e kufizimit të marketingut dhe publicitetit të tyre, me qëllim që t'i japim fund agresivitetit të paguar nga kompanitë e mëdha, që kanë fokus apo target të tyre të marketingut dhe tregtimit pikërisht këtë fazë moshore.

Në fund janë vendosur disa masa administrative.

Natyrisht, ju jeni familjarizuar shumë me aspektin e zbatueshmërisë së ligjit. Ligji që sot është në fuqi në aspektin e përdorimit të alkoolit, ka problematikën e tij të madhe në zbatim. Pas definimeve në ligj, duhet që të gjitha organizmat shtetërore, agjencitë që janë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, por në krahun tjetër, pse jo, edhe trupat pedagogjike nëpër shkolla,

veçanërisht ato 9-vjeçare dhe të mesme, duhet t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar zbatimit të këtij ligji. Agjencitë ligjzbatuese duhet të shtojnë kontrollin në të gjitha ambientet, jo vetëm për fëmijët, por edhe për personat e rritur që i shoqërojnë, blejnë për ta dhe natyrisht ua japin fëmijëve këto produkte që janë të ndaluara për t'u tregtuar drejtpërdrejtë për ta, por, në krahun tjetër, edhe për të kontrolluar ato që në gjykimin tim janë kthyer në problemin më të madh, klubet, e veçanërisht klubet e natës, që janë të hapura për fëmijët, adoleshentët, veçanërisht ata të moshës 15 – 18 vjeç, ku prodhohen në mënyrë të qartë jo thjesht pije energjike, por bomba toksike, që shpesh herë njihen si koktejlë me emra ekzotikë nga më të habitshmit, por që nuk kanë asgjë ekzotike në raport me shëndetin e fëmijëve dhe veçanërisht të atyre 15-18 vjeç.

Ndryshimet që kemi propozuar kanë të bëjnë me futjen e konceptit të ndalimit të tregtimit të pijeve energjike për fëmijët, futjen e konceptit të kufizimit të reklamës apo marketingut agresiv me fokus këto fasha moshore.

Së treti, ndëshkimin e çdo rasti kur ky ligj me këto kufizime shkelet dhe ku pasoja bie mbi fëmijën.

Ju jam shumë mirënjohës që më dëgjuat dhe për mundësinë që më dhatë për t'i sqaruar një për një të gjitha këto elemente që ne kemi dashur të materializojmë në këtë nismë.

Ju falenderoj ju, por mbi të gjitha kolegët e mi të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, që nuk kanë hequr dorë për asnjë minutë nga dëshira e tyre për t'i vënë fre këtij fenomeni, qoftë me masa fiskale, qoftë edhe në këtë mënyrë, e cila ka modele të ngjashme thuajse në të gjitha vendet më të rëndësishme të Bashkimit Europian!

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Shumë faleminderit zoti Braçe!

Na keni bërë me krahë me këtë nismë, të cilën e mbështesim plotësisht, duke marrë parasysh se edhe në ambiente shkolle, ku ne hyjmë, shikojmë marketing për pijet energjike, por edhe fëmijë deri në moshën 10 vjeç apo edhe më të vegjël që blejnë pije energjike në dyqan.

Vazhdojmë me pyetje dhe diskutime.

Po, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Dua ta komplimentoj Erionin, i cili në shumë aspekte është shembull i të qenurit parimor dhe ky rast është i tillë.

Problematika e ushqimit të fëmijëve është një problem i madh për të gjithë që kanë fëmijë, është shumë serioz dhe bën mirë që edhe në aspektin ligjor merr këto përmasa.

Në të gjitha ato që tha Erioni, për dëmet që sjellin këto substanca në organizmin e njeriut, po ju jap një shembull të thjeshtë. Imagjinoni sikur ky është stomaku dhe po të fusim kafeinë, alkool dhe substanca të tjera formohen produkte, të cilat janë më toksike se lëndët

fillestare dhe ky është rasti i përdorimit të lëndëve energjike me alkoolin, pa folur për dëmet që sjellin ato në veçanti. Stomaku është një enë e mbyllur, ku futen substanca nëpërmjet ushqimeve dhe aty ndodhin edhe reaksione kimike, të cilat japin produkte që janë më toksike se substancat fillestare.

Një moment shumë i rëndësishëm që Erioni e preku dhe unë dua ta theksoj, që të bëhet pjesë e kurrikulës, është mënyra e të ushqyerit, sepse tekstet e kanë mënyrën e të ushqyerit, por nuk e kanë të *apdejtuar* me problematika të ngjashme, që çdo ditë praktika i sjellë si shembuj negativë dhe që ne duhet t'i fokusojmë. Ndodh shumë shpesh që fëmijët dëgjojnë më shumë në shkollë apo njeri-tjetrin sesa prindërit, prandaj kjo problematikë duhet të marrë seriozitetin e duhur edhe në tekstet shkollore, edhe në komunikimet me mësuesit, në mënyrë që të marrë rëndësinë e duhur.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Po, zonja Kushi!

Evis Kushi – Së pari, dua të falënderoj shumë kryetarin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, kolegun Erion Braçe, për prezantimin e kësaj iniciative pro edhe për të gjitha argumentet që parashtrroi.

Unë personalisht jam shumë dakord, por jam e sigurt që edhe të gjithë kolegët, sepse është një problematikë që ne prej kohësh e kemi diskutuar, mungonte vetëm të bëhej realitet dhe askush nuk mund ta bënte më mirë se kolegu Braçe. Por ajo që më shqetëson në lidhje me këtë nismë është implementimi, të cilin ju e prezantuat. Nuk e di nëse i kemi kapacitetet e mjaftueshme në institucionet ligjzbatuese për ta zbatuar siç duhet këtë nismë. Ne nuk duam të kemi thjesht ligje në letër, por për ne është e rëndësishme që të zbatohet. Pyetja ime është: a ka një dakordësim me qeverinë dhe a janë bërë diskutime për këtë? Do të ishte mirë që në këtë diskutim të ishin të pranishëm edhe përfaqësues të qeverisë. Ne jemi të gjithë dakord me hartimin e ligjit, madje jam e bindur që po të kishte qenë opozita e pranishme, do ta kishte miratuar këtë projektligj, por shqetësimi im lidhet vetëm me implementimin nëse do ta bëjmë ashtu siç duhet, nëse do të kemi dakordësimin nga qeveria dhe nëse do të kemi kapacitetet e duhura për ta kontrolluar dhe zbatuar siç duhet.

Erion Braçe – Zonja Kushi, natyrisht që shqetësimi prioritar për ne ky ka qenë edhe problemi më i rëndësishëm në momentin që ne u ulëm të draftonim këtë projektligj, lidhet me zbatimin e tij. Ka vende në Europë që këtë çështje e kanë zgjidhur me përgjegjësinë sociale të vetë kompanive, prandaj e përmenda shembullin britanik. Kompanitë kanë një dimension social të tyre, që në një moment të caktuar ndalojnë dhe natyrisht merren drejtpërdrejt me këtë çështje dhe thonë: “Stop! Për këtë fashe moshe, ne do të ndalojmë konsumimin e tyre”. Ka

vende të tjera, si Britania, që vjen me një iniciativë të tillë, ku ligji është më i rëndësishëm sesa Mbretëresha; mjafton të jetë e shkruar në ligj dhe të gjithë të tjerët kanë detyrimin e qartë për ta zbatuar atë. Ka vende si ne, ku personazhe jo vetëm publikë, por edhe politikë, deri edhe te segmente të caktuara të medias që më së shumti janë të dhënë pas përfitimeve apo, në rastin tim si deputet ose kandidat për deputet, kënaqjes së turmës që kanë përpara, që do të thotë, duke filluar nga unë i pari, se në fushatë elektorale ka ndodhur që të jetë qerasur kuorumi që ka qenë për të dëgjuar programet politike pikërisht me produkte të tilla dhe ka vijuar, vijon pjesë-pjesë në të gjitha segmentet, përfshirë kompanitë dhe medien, që ta vënë përpara kur ti je i ftuar dhe je i detyruar ta asociosh fytyrën tënde pikërisht me produktin që ke sipër tavolinës për t'i bërë reklamë. Kështu që në këtë pikë në Shqipëri, ajo që merr prioritet është forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe, natyrisht, mbështetje totale me çdo gjë. Ne, anëtarët e Komisionit të Ekonomisë, kemi edhe një detyrë tjetër, mbështetjen me fonde buxhetore të këtij inspektorati për të kryer detyrën në të tria aspektet: edhe për duhanin, edhe për alkoolin, edhe për pijet energjike. Pra, duhet që ISHSH-ja të bëjë maksimumin e vet me shembuj konkretë, sepse, nëse sot kemi një zbatueshmëri të ligjit për duhanin në një përqindje që mbetet për t'u lavdëruar, këtë e ka bërë forca e veprimt të këtij inspektorati dhe, natyrisht, forca e shembujve që ka krijuar ky inspektorat në territor. Kjo duhet të ndodhë edhe për këtë rast.

Lidhur me fëmijët, do të duhet të punojnë edhe me tre turne për të kontrolluar klubet e natës dhe të mos lejohet që këto produkte, në origjinë të tyre të dëmshme, të kthehen në bomba toksike në momentin që duhet festuar, duke u harbuar dhe duke u ushqyer pikërisht me lëndë të tilla përmes kokteileve në festa. Pra, thelbi i zbatimit të këtij projektligji duhet të jetë pikërisht Inspektorati, por nuk duhet të lihet pas dore ajo që unë mendoj se duhet të jetë po aq prioritare, kurrikula shkollore. Mësuesi duhet të insistojë deri në fund për të bindur fëmijët që ka në administrim brenda një klase, për dëmin që sjell konsumi i këtyre produkteve. Pa asnjë lloj diskutimi, cilido që do të bëhet pjesë e kësaj nisme, që nga ne deri tek i fundit në cilëndo medie, që i adresohet kësaj fashe popullore, të miturve, fëmijëve dhe adoleshentëve, duhet ta kthejë në qëllim të saj përgjegjësinë sociale për të mbrojtur fëmijët nga konsumi i tepërt apo qoftë edhe normal i pijeve energjike, apo pijeve të gazuara me sheqer të shtuar.

Elisa Spiropali - Fjalën e ka zoti Beqiraj. Pastaj fjalën e ka zonja Gjylameti dhe zonja Hysi.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Zoti Braçe ju falënderoj për nismën që keni marrë, e cila ka të bëjë me një shërbim të madh njerëzor dhe social për të sotmen dhe të ardhmen e racës njerëzore.

Pyetjet e mia janë këto: a duhen mirëthelluar ndryshimet e këtij ligji, duke parë edhe fenomenet që kanë ndodhur, për këtë shtresë sociale tepër të brishtë të fëmijëve, deri në moshën 18-vjeç, dhe t'i bashkohej edhe një nismë e qeverisë, ku ndryshimet të ishin më të thella dhe jo të fokusoheshin vetëm në përdorimin e alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara me sheqer?

Pyetja e dytë lidhet me masat detyruese, sidomos me mbarëvajtjet administrative. Duke parë që përdorimi i këtyre pijeve nga kjo shtresë sociale është një bombë me efekt të vonuar në shëndet, gati-gati masat detyruese janë simbolike ndaj subjekteve, që i nxisin dhe i tregtojnë, kur thjesht për një rrip sigurimi që mban një shofer, gjoba është 200 mijë lekë të vjetër. Vetëm subjektet duhet të penalizohen, po mbartësi i pijeve nuk duhet të penalizohet?

Erion Braçe – Kush?

Ismet Beqiraj – Mbartësi i pijeve, konsumatori që përdor pijen, sidomos shoqëruesi ose imponuesi, kur shoqërues shpeshherë janë edhe prindërit, duke u plotësuar atyre kërkesat ekstravagante.

Po konsumi, sidomos i pijeve alkoolike, jashtë sektorit të shërbimit, sepse ne nuk kemi vetëm fëmijë që shkojnë në klubet e natës, në lokale, por jashtë sektorit të shërbimit?

Si përfundim, dua t'ju propozoj, që ashtu sikurse bëhet antireklama për cigaret te paketa: “Duhani dëmton shëndetin”, t'i imponohet të gjithë sektorit të industrisë së prodhimit, sidomos ushqimor, të të gjithë pijeve që janë objekt i këtij ligji, antireklama se këto pije dëmtojnë shëndetin e të miturve deri në moshën 18 vjeç, pra të jetë detyrim.

Te reklamat që bëjnë mediet vizive, ju keni zgjedhur elementin kohë tek emisionet dedikuar fëmijëve, 15 minuta para dhe pas emisionit. Mbi cilët kritere jeni bazuar, pse jo një orë përpara, ose një orë pas, ku fëmijët t'i ketë zënë edhe gjumi, pas emisionit?

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, profesor!

Natyrisht, ndryshimet që kemi sjellë janë ndryshime që bëhen për herë të parë. Domethënë, kufizimet që materializojnë këto ndryshime, janë kufizime që vendosen për herë të parë në ligj. Praktikisht, një gjë që vjen për herë të parë, mendoj se si kufizim është i thellë, mund të kishte edhe kufizime të tjera më të thella, por jemi të detyruar t'i referohemi legjislacionit të përafërt të disa vendeve të Bashkimit Europian, që kanë ndërmarrë këtë masë. Pikërisht, kemi qëndruar në ato kufizime që kanë vendosur edhe këto vende.

A duhet të jenë më të thella? Unë jam i hapur, nëse duhet të ketë kufizime të tjera edhe më të thella, pa asnjë lloj diskutimi deri në seancë plenare mund t'i bëjmë ndryshime nismës,

për të vendosur kufizime edhe më drastike, në qoftë se janë të mirëkuptueshme nga pjesa e kolegëve.

Në përgjigje të një pyetje vijuese: për herë të parë në këtë projektligj kemi vendosur edhe konceptin e shoqëruesit që i ble këto produkte për t'ia dhënë fëmijës që do t'i konsumojë. Kësaj radhe me ligj, me këto ndryshime që kemi vendosur, vendoset gjobë edhe për ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Te cila pikë se nuk e pashë, prandaj e bëra pyetjen?

Erion Braçe - Ne do të vijmë në shqyrtimin nën për nën dhe mund ta evidentojmë.

Kjo është risi për prindin apo për ata që tutelojnë fëmijët nëpër lagje. Ka disa më të mëdhenj që mbajnë grupe fëmijësh rreth e qark për t'i përdorur, shpeshherë për punë të pista, fillojnë dhe i joshin edhe me të tilla elemente: një pije energjike këtu, një pije energjike atje matanë, e kështu me radhë. Pra, edhe për këtë lloj kategorie është vendosur kufizimi dhe ndëshkimi me gjobë.

Për konsumatorin nuk besoj. Pra, të kapësh një fëmijë dhe ta gjobisësh, mund të jetë traumë. Për shembull, për një fëmijë 12, 13 dhe 14 vjeç që të hasi në momentin e parë me gjobitjen për këtë punë, plus që do të hapet historia, sepse fëmija në atë moshë është i papërgjegjshëm dhe duhet t'i gjesh shtëpinë, të shkosh te familja e të tjera me radhë, që në këtë aspekt mund ta bënte ligjin të pazbatueshëm.

Kurse për kufizimin e reklamës, natyrisht që i jemi referuar një standardi që është marr pikërisht nga legjislacioni i këtyre modeleve që ne kemi parë, çerek ore para, çerek ore pas, sepse besoj se nuk ka fëmijë që të rrijë një orë para ekranit në pritje të një emisioni, ku mund të shfaqet kjo lloj reklame. Nuk e mendoj kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, keni shumë të drejtë që mund të jetë një dimension tjetër, fëmijët tashmë i gjen në internet nga mëngjesi deri në mbrëmje, duhet ta shikojmë këtë. Por ne nuk arritëm të gjenim një model të ngjashëm për kufizimet edhe në internet të kësaj gjëje, sepse ka faqe të posaçme, ku fëmijët hyjnë, siç hyjnë edhe në faqet *online* të kompanive të basteve, ku pa asnjë lloj diskutimi, duhet vendosur edhe ky lloj kufizimi për reklamën e pijeve energjike. Ka edhe ambiente të tjera, si kinematë apo stadiumet, ku fëmijët janë prezentë dhe në më të shumtën e kohës ndeshen me agresionin edhe të këtij publiciteti.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti - Faleminderit!

Së pari, falënderoj kolegun Braçe për nismën, që vjen edhe si përgjigje e shumë shqetësimeve që kemi pasur të gjithë, jo vetëm si nënë, por edhe si anëtare e Komisionit të

Ekonomisë dhe Financave, ku kemi diskutuar dhe debatuar shumë herë për mënyrën se si mund ta kufizonim përdorimin e pijeve energjike apo atyre që janë kalorike, me sheqer të shumtë dhe ndikimin që kanë te fëmijët.

Ndërkohë, jam shumë e lumtur që kjo nismë vjen edhe në vazhden e një sërë nismave apo vendimeve të ministrive përkatëse, qoftë në ndryshimin e kurrikulave të bëra tashmë realitet nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu, mendoj, dhe jam e bindur për këtë, se fakti i shoqërimit të këtyre me një kurrikul të posaçme, pikërisht për të ndërgjegjësuar fëmijët, për t'i edukuar për efektet që kanë pijet energjike, do të ishte shumë e domosdoshme. Sado që të kufizojmë me reklama, me ligje përkatëse apo me implementimin e tyre, nëse ne nuk e nisim që nga gjeneza, pikërisht t'i edukojmë me çfarë efektesh kanë, besoj se nuk do t'ia dalim dot që të marrim ato rezultate që ne presim.

Ndërkohë, ka një element tjetër të kurrikulat që sot kanë, duke qenë mamaje e një fëmijë 10-vjeçar, të "Qytetaria", ata i kanë të përfshirë. Kështu që duhet parë kurrikula për t'i ndërgjegjësuar më shumë, sepse kur flasim për yndyrat e shëndetshme dhe yndyrat e pashëndetshme, kur flasim për sheqerin dhe ndikimin që ka, të flasim edhe për çështjet e kafeinës apo të elementeve të tjerë që kanë pijet energjike.

Nga ana tjetër, një element ku mendoj se duhet të fokusohemi shumë, janë fushatat e ndërgjegjësimi, për efektet negative që kanë këto pije, domethënë duhet një koordinim më i mirë me ministritë përkatëse dhe me inspektoratet me radhë.

Së pari, të ndërgjegjësimi përveç kurrikulës, edhe për ata që janë më të rritur, pra që nuk e kanë pjesë të kurrikulave të tyre, të kemi fushata të mirëfillta ndërgjegjësimi.

Nga ana tjetër, kjo duke e kombinuar edhe me forcimin e kapaciteteve për implementimin e ligjit, mendoj se do t'ia dalim shumë mirë, që kjo nismë të bëhet realitet dhe të ndikojmë jo vetëm sot në shëndetin e fëmijëve, por për gjithë jetën e tyre.

Zoti Braçe, unë mendoj se kjo duhet të shoqërohet edhe me një ndryshim ligjor tjetër, sikundër e kanë shumë vende të tjera, pajisja me kartë identiteti për përdorimin e disa pijeve. Duke e kombinuar me këtë, mund të arrijmë që edhe për realitetin që kemi sot të marrim një nismë, e cila është automatikisht e zbatueshme, pra kombinuar me të gjitha.

Ju falënderoj shumë! Mendoj se të gjithë si kolegë, të të gjitha komisioneve, duke u përfshirë në personalisht në fushata ndërgjegjësimi, mund t'ia dalim, që nëpërmjet nesh dhe shumë të tjerëve të kuptohet realisht, sepse në shumë zona ka mungesë informacioni. Unë si mama mund të ulem dhe të lexoj, por ka shumë të tjerë që nuk e dinë çfarë efekti ka dhe, mbi të gjitha, nuk kuptojnë varësinë që krijojnë këto pije, që janë shkatërruese për vazhdimësinë e jetës.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti.

E gjej me shumë vend atë që tha zonja Gjylameti.

Natyrisht, ka një përpjekje shumë të madhe, ka një lëvizje shumë të madhe, që fillon nga ata që prodhojnë deri te Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Arsimit, të cilat po fusin në shkolla konceptin e ushqimit të shëndetshëm, madje duke u ofruar edhe vakte. Natyrisht, tashmë modelet e testuara duhet të bëhen masive pothuajse në çdo institucion. Jo më larg se sot në mëngjes pashë një model të shkëlqyer që vinte nga Korça, nga një prej shkollave atje. Ka këtu në Tiranë, ka gjithandej që po përhapen. Po thellohet përgjegjshmëria përkundrejt fëmijës dhe institucioneve shtetërore në raport me ushqimin. Kjo gjë duhet të bëhet edhe më agresive. Pa asnjë lloj diskutimi duhet të mbështetet akoma më shumë me buxhet. Nëse ne sot jemi të kënaqur që kemi rritur buxhetet për arsimin apo për shëndetësinë, por jo kaq të kënaqur për bujqësinë, për shembull, pa diskutim duhet ta mbështesim edhe me buxhetim, pasi jemi para buxhetit. Ndodh kudo që tavanet buxhetore të negociohen me deputetët dhe të negociohen për qëllime të mira, për qëllime publike, që kanë fokus të caktuar jo vetëm kauza, por edhe iniciativa, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shëndetin e fëmijëve. Pra, ajo që ju thoni për kurrikulat që sot ekzistojnë, shtuar me modelet shumë të mira për ushqimin e shëndetshëm që po hyjnë nëpër shkolla, madje edhe me fushata sensibilizuese, pa asnjë lloj diskutimi që duhet të thellohet, por me një kusht: duhet të kemi të gjithë të njëjtën qasje, sepse për mua është e papranueshme që të organizosh një festë balonash dhe e gjithë festa të jetë e sponsorizuar nga një pije energjike. Është e tmerrshme, balona ngrihet në ajër prej ajrit dhe atij fëmije që e mban në dorë, ajo nuk fluturon me krahë për shkak të taurinës. Pra, duhet të kemi të gjithë një qasje, si institucione shtetërore apo si individë të angazhuar politikisht apo edhe publikisht, shoqëritë civile e të tjera për ta çuar deri në fund këtë nismë.

Në krahun tjetër, e kemi vendosur detyrimin për dokumentin e identitetit, siç është për alkoolin; do të jetë i njëjti model edhe për pijet energjike, pa asnjë lloj diskutimi në këtë aspekt.

Në fund, pa diskutim e gjej të lavdërueshme në mënyrë të qartë, organizimin e fushatave ndërgjigjëse nga 15 - 18 vjeç. Unë kam vetë një fëmijë në shtëpi, kthehet në luftë, ka prindër që e përballojnë ta bëjnë këtë gjë, mund t'ju ketë shkuar jeta luftë, sepse e kanë mënyrë jetese të bëjnë betejë edhe me fëmijën. Ka të tjerë që kanë mbi supë detyrimin për të mbajtur familjet dhe nuk e gjejnë këtë kohë. Atëherë këtyre njerëzve duhet t'u bëhemi krahë, me qëllim që të shkojmë deri në fund në bindje përkundrejt fëmijëve, por të mos harrojmë një gjë: në një moment të caktuar të ndalemi dhe të reflektojmë për kapitalizmin që po

ndërtojmë. Ky është problem shumë i madh. E di se ka jashtë kësaj salle plot njerëz që mund të thonë: “Çfarë jeni ju, pse shteti duhet të ndërhyjë deri këtu, çfarë është kjo histori, pse me komunistllëqe do të merremi?!”, e ku e di unë të tjera të këtij lloji. Kam përshtypjen se nuk është kështu. Ata që e kanë rregulluar para nesh këtë problematikë, i kanë kushtuar një vëmendje shumë të madhe përgjegjësisë sociale të kompanive, nuk kanë thjesht dhe vetëm për qëllim të fitojnë. Unë e kuptoj se nga një kanoçe fitohet, fitohet mirë, për më tepër kur nuk është kanoçe, por është bidon 1,5 litra me një lëng që mund të ketë një përbërje çfarë t’ju them! E gjen shpesh në të gjitha zonat rurale apo në supermarketet e dorës së tretë, apo të katërt në këtë vend, por në një moment të caktuar edhe këta njerëz duhet të ndalen. Kanë organizimet e tyre, kanë dhomat e tregtisë, kanë institucione të tjera, të cilat në një moment të caktuar duhet të thonë: “Stop!”. Të përqendrohemi këtu dhe të fitojmë nga e mira, jo nga ajo që bën dëm. E gjitha kjo vlen, sepse nesër do të kemi të njëjtin diskutim në këtë sallë. Do të kemi të njëjtin diskutim me të gjithë ata që kanë të paktën 2 javë që i mëshojnë sikletit të tyre, se po humbin fitimet nga një aktivitet kriminal për mua, siç është bixhozi, veçanërisht ai i paligjshëm dhe nuk ndalen të mendojnë për mijëra familje që shpenzojnë në vit 600 milionë euro pikërisht për të ushqyer këtë biznes, këtë sipërmarrje. Pra, duhet edhe një lloj ndërgjegjësimi përkundrejt tyre, nëse nuk e bëjnë dot vetë, hajdeni të bëhemi pjesë dhe të përballemi edhe me ta për t’i shtyrë që të reflektojnë në këtë aspekt, në aspektin social të aktivitetit të tyre, në këtë që e quajmë kapitalizëm.

Elisa Spiropali - Kanë vendosur t’i dalin për zot të gjitha aktiviteteteve që kanë efekt rrënues, psikologjik dhe fizik, por ne vazhdojmë përpara.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja Spiropali!

Shumë faleminderit kolegut Braçe për këtë nismë të mrekullueshme! Është pak e vonuar, por më mirë vonë sesa kurrë.

Në fakt, është një nismë shumë e mirë dhe unë e vlerësoj shumë, pasi, së fundi, në Kuvendin e Shqipërisë po u rikthehem disa nismave që kanë një impakt të gjerë social, ekonomik në një grup të gjerë të popullatës, pavarësisht se na ka votuar ose jo.

Lexova me vëmendje relacionin që shoqëron nismën tuaj dhe sinqerisht e vlerësoj informacionin shumë të detajuar që keni sjellë lidhur me ndikimin negativ që kanë pijet energjike, pijet me sheqer të shtuar, sikurse ndihem keq se informacioni për Shqipërinë është shumë i paktë, vetëm në një studim që lidhet me obezitetin, çfarë do të thotë se edhe ne, në kuadër të mbikëqyrjes parlamentare, do të kërkonim më shumë nga institucionet shtetërore, për

të kryer më shumë studime në lidhje me çështjet të cilat kanë një impakt në jetën ekonomike, sociale, por, mbi të gjitha, në shëndetin e të gjithë brezave, në mënyrë të veçantë të të miturve.

Unë pajtohem dhe ndaj të njëjtin shqetësim me të gjithë kolegët parafolës lidhur me impaktin që do të ketë ky projektligj. Ai ka një impakt të jashtëzakonshëm dhe ju, zoti Braçe, jeni modeli më i mirë se si një deputet kontribuon në zbatimin jo vetëm të interesit më të lartë të fëmijëve, që është një nga detyrat që kemi, por edhe të dy rezolutave që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë, për të nxitur deputetët për të marrë nisma në mbrojtje të të drejtave dhe të shëndetit të fëmijëve, rezolutë që në vitin 2013, si edhe ajo që lidhet me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, ku kemi një sërë objektivash që lidhen me mirërritjen, ushqyerjen dhe shëndetin e fëmijëve.

Nga ana tjetër, kam një shqetësim, një merak që dua ta ndaj me ju, meqenëse drejtoni një komision shumë të rëndësishëm, jeni shumë aktivë, komisioni juaj ka deputetë jashtëzakonisht aktivë që mund të kontribuojnë. Unë mendoj se nuk mjafton vetëm rritja e buxhetit që duhet të bëjmë për vitin e ardhshëm për të pasur mundësi për sensibilizim dhe informim shumë të mirë, por duhet të forcojmë kontrollin parlamentar. Meqenëse edhe kolegja Ekonomi edhe kolegja Spiropali janë në komisionet që lidhen me mediet, me çështjet sociale, më shumë kujdes ne duhet t'i kushtojmë kur raporton AMA për zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me monitorimin e ligjit dhe të reklamave.

E dyta, lidhur me AKU-në, me shoqatat e konsumatorëve, me shoqatat e biznesit, ndoshta do të ishte shumë mirë që të zhvillohet një seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit, për t'i sensibilizuar dhe të mos kthejnë atë revansh, siç na u kthyen, shumë prej nesh morën mesazhe deri kërcënuese në telefonat tanë personalë për bastet.

Kam edhe një sugjerim tjetër lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë. Kuvendi, duke filluar nga kjo nismë shumë e mirë e kolegut Braçe, do të ishte pozitive të fillonte të maste impaktin që do të ketë zbatimi i këtij ligji në faturën financiare që ne shpenzojmë për insulinat, për fëmijët diabetikë, për probleme të tjera që lidhen me shëndetin, sepse në këtë mënyrë do të kuptojmë se ky ligj ka edhe një impakt mjaft të madh financiar në xhepat dhe në portofolin e çdo familjeje shqiptare.

E fundit, unë kam edhe një sugjerim, këtu është shtuar, ju keni bërë një amendament te neni 8, ku flitet për ndalimin e pijeve alkoolike në institucionet arsimore. Mendoj se duhet ta zgjerojmë. Të parët ne, deputetët, kur bëjmë dhurata, organizojmë festa me fëmijët edhe në qendrat rezidenciale, në shtëpinë e foshnjës e të tjera, kemi dërguar coca-cola, fanta, pepsi, shishe të mëdha dhe të vogla. Pra, të parët fare jemi ne që nuk duhet ta bëjmë një gjë të tillë. Nuk duhet të lejohet që në rastet e donacioneve, ndihmave, dhuratave të ofrohen te fëmijët

këto pije në rastet e festave. Pra, kërkohet një sensibilizim dhe një fushatë shumë më e gjerë. Kjo duhet të shtohet te neni 8, të shtohet termi i përshtatshëm “qendra sociale”. Ndoshta kolegja Spiropali dhe koleget e tjera që janë në Komisionin për Çështjet Sociale duhet të gjejnë termin e saktë që duhet të shtohet, për të përfshirë jo vetëm shkollat, por edhe qendrat e tjera, ku rriten dhe edukohen fëmijët që janë për kujdes social e të tjera.

Zoti Braçe, unë do t’ju uroja edhe njëherë për nismën shumë të mirë, por edhe ne, si Kuvend, do të marrim angazhimet tona direkte për të matur impaktin e ligjit, por edhe për të ushtruar më mirë kontrollin parlamentar ndaj institucioneve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin e këtij ligji dhe me monitorimin e tij.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Hysi!

Fare shkurt, dy gjëra lidhur me ato që ju thatë.

Unë e kuptoj, mund të jetë një nismë e vonuar, por e gjithë përpjekja që kemi bërë që në krye të herës, që në momentin e parë, kur ne patëm përgjegjësi më të mëdha në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, kishte të bënte me një qasje fiskale. Vendosëm një akcizë, e cila ishte pesë lekë për njësi, për kanoçe tregtimi e të tjera me radhë. Nuk funksionoi. Konsumi vijoi të rritej. Pesëlekëshi, përballë marketingut agresiv... Më lejoni t’ju them, sepse dua ta theksoj: unë kam punuar në medie dhe e kuptoj se sa efektive është një gjë e thjeshtë. Po të shikosh reklamat e këtyre kompanive, janë aq të thjeshta, sa godasin pikërisht te kjo fashë njerëzish. Kjo fashë njerëzish e kap prindin prej xhakete. Kjo fashë njerëzish i fut dorën në portofol prindit, për të shkuar pastaj e për të blerë matanë e të tjera me radhë. Ai pesëlekëshi nuk bënte punë. Nga modelet që ne pamë, duke filluar nga Franca e tutje, se si e ngarkonin me barrë fiskale, me akcizë, ajo masë ose ka vlerë të bëhet e plotë, pra të jetë e rëndë, që ta bëjë të shtrenjtë produktin për këtë fashë njerëzish, të miturisht apo adoleshentësh, ose nuk ka asnjë lloj kuptimi. Me pesë lekë kjo histori dështoi.

Duke pritur që ky pesëlekëshi të kishte efekt, jemi vonuar pikërisht për këtë masën tjetër. Kjo masa tjetër ngarkon me përgjegjësi, duhet të bëjë aktive një sërë agjencish që ju përmendët: edhe AMA-n, për sa u përket reklamave, që më lejoni t’ju them, në historinë e bixhozit ka fjetur gjumë. Ka pasur një ligj përpara për ta zbatuar, por ka fjetur gjumë nga mëngjesi deri në darkë, ndërkohë që kishte emisione të posaçme thjesht e vetëm për të nxitur bastet, veçanërisht në ngjarje, si Kampionati Botëror, si Kampionati European, si Liga e Kombeve apo siç mund të jetë nesër, pasnesër, *Champions League* e kështu me radhë. Agresiviteti në ekrane, që AMA-s nuk i binte në sy, ishte maksimal; pra AMA, por pa asnjë lloj diskutimi edhe AKU-ja. Sepse ato bidonët për të cilët ju fola, që shiten në dalje të Unazës

së Vogël të Tiranës e tutje, për t'u përhapur në të gjithë Shqipërinë, po jua them unë që janë bomba toksike. Bomba toksike. Një litër e gjysmë bombë. Natyrisht, përbërja e tyre duhet kontrolluar deri nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, i cili, më tutje do të duhet të merret drejtpërdrejt me masat që ne kemi parashikuar këtu.

Në lidhje me vërejtjen që ju keni për nenin 8, do të doja t'ju thosha se sot është ndalimi i reklamave për pijet alkoolike. Shtohet për pijet energjike dhe ndalohet me përkufizim të posaçëm edhe për pijet e gazuara e me sheqer të shtuar. Natyrisht, ndalohen reklamat edhe në ambiente sociale, por është krejt legjitime ajo që ju thoni, sepse shkojnë njerëz të ndryshëm, përfaqësues të ndryshëm nga ne politikanët, në ditë të caktuara, deri te ata që kohët e fundit kanë zbuluar aktin e dhurimit si modë, që mbushin një pako, në të cilën ka pije me sheqer të shtuar, që adresohen në formate të mëdha: një litër e gjysmë – dy litra.

Elisa Spiropali – Zonja Bode e më pas zonja Xhembulla.

Edlira Bode – Shumë faleminderit!

Mbase do të përsëris pak ato çfarë thanë kolegët, por mendoj se sot është e rëndësishme edhe pak përsëritje.

Përgëzoj kolegun Braçe. Vura re me shumë vëmendje e kënaqësi renditjen e të gjitha efekteve negative që kanë mbi shëndetin këto pijet energjike e me sheqer të shtuar. Sjell në vëmendjen tuaj dhe tonën, se në Shqipëri kemi një nivel shumë të ulët të edukimit shëndetësor të popullatës. Duhet të fokusohemi pak këtu, sepse është një ligj që duhej ta kishim bërë më parë, por shumë mirë që po e bëjmë tani. Është shumë mirë që ky ligj sanksionon edhe masat administrative për të rriturit që ua ofrojnë fëmijëve këto lloj produktesh. Kryesisht, këta të rritur janë prindërit, por unë nuk mendoj se një prind, me dashje e me vullnet të lirë i jep fëmijës një produkt, duke e ditur shumë mirë që i bën dëm. Shumë herë, në masën më të madhe, prindërit shqiptarë nuk e dinë se sa shumë dëm u bën fëmijëve ky produkt që u ofrojnë.

Prandaj, shumë mirë që fusim kurrikulat nëpër shkolla, që do të bëjmë edukim shëndetësor në institucionet arsimore apo të kujdesit për fëmijët, por siç tha Blerina, duhet të organizojmë edhe fushata sensibilizuese për popullatën, kryesisht për prindërit, në mënyrë që vetë të bëhen frenues të përdorimit.

Siç e thatë ju shumë mirë, që për një fëmijë do të jetë traumë nëse, siç propozoi Ismeti, i vendoset një gjobë, një sanksion kur përdor pijen, por edhe kur i vendoset gjoba prindit ngaqë i ofron një kanoçe pije fëmijës, traumë është prapëseprapë, në rastin kur ai nuk e ka shumë të qartë se çfarë është duke bërë. Pra, pa tjetër që ligjin duhet ta shoqërojmë me këto fushatat sensibilizuese për gjithë popullatën.

Sjell në vëmendjen tuaj edhe faktin që, siç e thatë, ligji antiduhan pati një zbatim të suksesshëm. Konsiderohet si një ligj që zbatohet mirë në Shqipëri, kjo edhe ngaqë u shoqërua me fushata sensibilizuese. Kjo ishte një nga arsytet pse tani kemi një zbatim shumë të mirë të këtij ligji, por ndoshta jo në nivelet maksimale.

Unë mendoj se të gjithë ne, të dy komisionet, por edhe komisionet e tjera parlamentare, edhe çdo deputet në veçanti, duhet të angazhohemi, qoftë edhe personalisht, në fushatën sensibilizuese për popullatën, kryesisht për prindërit.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Përshëndetje!

Dua ta falënderoj shumë zotin Braçe për këtë nismë, e cila pa diskutim do të ketë një impakt të drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit të fëmijëve, por jo vetëm. Bëhet fjalë për ndalimin e një game të gjerë pijesh, të cilat kanë ndikim jo vetëm në shëndet, por mbase edhe në mënyrën e sjelljes të fëmijëve në shoqëri.

Nuk e di çfarë reagimi ka komuniteti i biznesit deri tani, në çastin kur ka marrë informacion për nismën, por nëse ata nuk kanë ndonjë reagim, mendoj se ne, ashtu siç u përmend edhe nga zonja Hysi, në një farë mënyre duhet t'i bëjmë ata partnerë e bashkëpunues në këtë nismë, duke qenë se ata janë në kontakt të drejtpërdrejt me konsumatorët. Kështu, me qëllim që sigurojmë zbatueshmërinë e ligjit deri në pikën më të fundit, mbase do të ishte mirë të gjejmë një instrument, i cili të mund të na sjellë më afër dhe të na bëjë më bashkëpunues, në partneritet me biznesin, si një prej aktorëve që afektohet nga nisma.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Xhembulla, shumë faleminderit! Pa asnjë lloj dyshimi, unë nuk lodhem së diskutuari këtë me cilindo, përfshi edhe grupet e biznesit. Do të doja t'ju thosha, këtu janë kolegët e mi të Komisionit të Ekonomisë, se në harkun e tre vjetëve që jemi marrë me këtë çështje, me barrën fiskale të kësaj, presioni i tyre mbi ne ka qenë skandaloz. Skandaloz! Për çfarë? Për atë pesëlekëshin që ju përmenda. Ka kompani që fitojnë jo pesë lekë, por 100 lekë për njësi. Për atë pesëlekëshin presioni ndaj nesh ka qenë maksimal. Kanë arritur deri aty sa kanë angazhuar edhe përfaqësi diplomatike të shteteve të origjinës, që kanë prodhuar apo prodhojnë këto pije. Unë kam marrë letra të tilla, që janë të paimagjinueshme. Nisma nuk synon të prishë biznesin, por nisma kërkon të zëvendësojë përgjegjësinë e munguar sociale të këtij segmenti të biznesit. Fare mirë, secili prej tyre mund të adoptojë biznesin e tij dhe të shesë lëng shege. Të shesin lëng shege! E do bio? E do origjinal? Po, të shesë lëng shege, meqë jemi në sezon. Pra, të bëjë atë që bëjnë ata djem atje në Fishtë, që mbledhin shegët e të gjithë zonës dhe ua ofrojnë klientëve me gota si lëng ose edhe si frut. Të bëjnë kaq!

Pra, janë dy modele biznesi komplet të kundërta, njëri që prodhon, që rropatet dhe ka një përgjegjësi sociale, që vjen për shkak të asaj pune që bën dhe që është e lodhshme, me thënë të drejtën, se ta gjurmosh shëgën pemë më pemë, kodër më kodër e mal më mal, në gjendje natyrale, të egër, siç rritet atje, natyrisht është e lodhshme, dhe këta të tjerët që e marrin, e sjellin këtu dhe duan të fitojnë maksimumin edhe duke përdorur fëmijët.

Unë s'e kam problem të ulem me ta, do t'i kemi në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, se do të vijnë për paketën fiskale, natyrisht, që janë të interesuar për të, dhe ta diskutojmë këtë çështjen e përgjegjësisë sociale dhe sipërmarrjeve të tyre, pa asnjë lloj diskutimi, por me ta hasëm këtë gjë, kur bëhet fjalë për barrën fiskale.

Elisa Spiropali – U ngrit shqetësim nga disa kolegë, zonja Kushi, zonja Xhembulla, dua t'ju bëj me dije se, në fakt, projektligji u është nisur për opinion edhe Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë, gjithashtu, edhe organizatave të të drejtave të fëmijëve, të shëndetit, Organizatës Botërore të Shëndetit, Save the Children, CRCA e me radhë të gjithave. Nga institucionet dhe nga shoqatat nuk kemi asnjë propozim për ndryshim, kështu që po e diskutojmë në parim propozimin e zotit Braçe.

Erion Braçe – Individualisht, nga njerëz që punojnë në këto institucione, po flas për institucionet publike, jam munduar të komunikoj me kë kam njohur e me kë kam mundur nga këto organizatat e shoqërisë civile për këtë gjë, por nuk kam marrë ndonjë *feedback* të rëndësishëm, nga biseda me njerëz që punojnë në institucione të shëndetit publik brenda administratës apo brenda qeverisë e të tjera me radhë, natyrisht që kam marrë opinione pozitive lidhur me nismën.

Një pjesë e këtyre personave kanë kontributin e tyre brenda draftimit të neneve të këtij ligji, një pjesë tjetër kanë zgjedhur thjesht të përkrahin. Në qoftë se do të ketë opinion prej tyre, pa asnjë diskutim unë jam i hapur për ta diskutuar këtë gjë.

Elisa Spiropali – Urdhëroni, zonja Ikonimi!

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Kolegu Braçe, shumë faleminderit për këtë nismë ligjore që keni ndërmarrë! Në fakt, për ne që iu bashkuam kësaj nisme, ka pasur edhe diskutime, siç thatë ju, jo në formë zyrtare, por në mënyrë personale, nëse është e mirë kjo iniciativë ligjore apo jo. Personalisht, dua të them se kam ndjekur me vëmendje gjithmonë, kur Organizata Botërore e Shëndetësisë ka bërë vrojtime,urvejime për obezitetin në Shqipëri dhe ne jemi futur në një hartë risku të obezitetit, që fillon jo vetëm për moshën madhore, por ajo që ka si karakteristikë Shqipëria është se po shkon te mosha adoleshente dhe e të vegjëlve. Prandaj kjo nismë shkon shumë për shtat me këtë frymë shqetësimi global, që ka OBSH-ja sot për obezitetin e shtuar në të gjithë botën.

Ndërkohë, nga ana tjetër, shumë vende, ju i keni përmendur edhe në relacion, jo vetëm të BE-së, por edhe të OECD-së, domethënë se kufiri po përhapet në të gjithë globin, po marrin masa për të ulur mundësinë e shtimit në peshë për moshat e reja apo edhe për ato që janë të rritur.

Unë doja të shtoja diçka që është shumë e rëndësishme. Edhe nga diskutimet që kemi bërë herë pas herë në Kuvend, edhe me grupin “Miq të Fëmijëve”, vihet re se ne nuk i japim vëmendjen e duhur procesit të të ushqyerit dhe nuk kemi pasur asnjëherë tavolina të drejtpërdrejta për ushqyerjen, edhe pse jemi marrë me tema të mëdha, siç është, për shembull, ndjekja e shkollës, përqendrimi që ato kanë apo varfëria, kështu që nevoja për ta pasur këtë pjesë të diskutimeve tona publike në Kuvend do të vijë detyruesisht edhe pas kalimit të këtij ligji.

Tjetra që doja të shtoja është se vëmendja për të matur obezitetin ka qenë dhe do të vazhdojë nga OBSH-ja, kështu që kjo nismë do të ketë një monitorim natyral, që vjen si rutinë e punës së institucioneve.

Nga ana tjetër, ne duhet të shtojmë vëmendjen që ka popullata për nismën dhe na takon që në Kuvend të marrim dhe të bëjmë disa tavolina për ushqyerjen e shëndetshme.

E treta, është që secili nga deputetët, të paktën në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, që ka qenë i përfshirë në nismë, duke pasur reagime për çdo nen apo edhe për nismën në përgjithësi, kur diskutuam për relatorin, ra dakord për zonjën Adelina Rista. Këtu kemi ardhur me një propozim, i cili ka qenë propozim i zonjës Rista, sepse ajo vjen me një profesionalizëm shtesë për ne, që është drejtimi i institucioneve të arsimit parauniversitar. Ndërkohë, diskutimi vazhdoi edhe me zonjën Spiropali dhe ramë dakord që të kemi një relator të përbashkët, zonjën Rista, që të përfaqësojë të dy komisionet, kur të diskutohet kjo nismë ligjore në Kuvend.

Dua të shtoj se e di shumë mirë sa e fortë bëhet lidhja midis bizneseve, fitimit dhe shëndetit të mirë në komisionin tuaj. Unë e kuptoj që iniciativa është juaja, personale, por kuptoj edhe faktin se frymëzimi vjen nga puna që ju bëni në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, profesoreshe!

Do të doja të shtoja vetëm një gjë, ma sollët ju në vëmendje, se e gjithë kjo është edhe ekonomi, është ekonomi për buxhetin e shëndetësisë që ne kemi, është ekonomi edhe për familjen, kështu që të gjithë duhet ta kuptojnë edhe në këtë aspekt. Për një fëmijë obez në shtëpi, ne si prind paguajmë, për fat të keq, që ai të pësojë atë gjë; ai do të jetë akoma shpenzim

edhe më i madh si për familjen, por edhe për buxhetet e shëndetësisë nesër apo pasnesër. Kështu që jemi munduar ta shohin edhe në këtë aspekt, pra në aspektin e të bërit ekonomi.

Elisa Spiropali – Urdhëroni, zonja Spahiu!

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Në fakt, nuk dua të përsëris kolegët, por kam disa gjëra që dua t'i ndaj me Erionin.

Së pari, e vlerësoj shumë si koleg dhe, e dyta, punët e mira duan shumë guxim, sepse kjo secilit prej nesh mund t'i ketë shkuar në mendje, por nuk kemi pasur guximin ta bëjmë.

Ju, pavarësisht se keni kohë, dy apo tri vjet që e keni menduar dhe merreni me këtë nismë, në fund ia dolët dhe për këtë ju përgëzoj. Ju përgëzoj, sepse është e vërtetë se ne këto kohë mund të kemi marrë mesazhe të ndryshme në lidhje me bixhozin, mesazhe diku kërcënuese e diku të formave të ndryshme, por fatkeqësisht fëmijët dhe adoleshentët nuk kanë fuqi të na çojnë mesazhe për të na treguar se kanë nevojë që ne të kujdesemi për shëndetin e tyre. Politikat duhet të kenë këtë synim dhe shpresoj shumë që në të ardhmen kjo gjë të nxisë edhe kolegët e tjerë, duke përfshirë edhe veten. Them se duke ditur pasojën e mesazheve kërcënuese që ju keni marrë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me frenimin, kryesisht të pijeve energjike, gjithkush stepet dhe mendon se pse ta fusë veten në bela.

Në fakt, ne duhet ta fusim veten në bela, sepse fëmijëve u kemi shumë borxhe, jo vetëm në mënyrën e të ushqyerit. Nëse ne nuk kemi mundësi të ndryshojmë gjëra në mënyrë të menjëhershme siç është, për shembull, ndotja e mjedisit, përmirësimi i ajrit, nuk e bëjmë dot menjëherë këtë, se janë politika shumëvjeçare, kemi detyrimin të realizojmë gjëra të vogla, të thjeshta, që mbrojnë shëndetin. Në qoftë se nisemi nga ana financiare, po fokusohem te konsumi i sheqerit. Hulumtimet shkencore për dëmin që sjell sheqeri, konsumi i sheqerit te fëmijët dhe adoleshentët, kanë vërtetuar se ka një predispozitë shumë më të lartë që pas disa vjetësh të shfaqet diabeti në moshën e rritur. Mjekimet që merren me sëmundjet kronike harxhojnë më shumë se gjysmën e buxhetit të shëndetësisë, kryesisht për diabetin dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Më ka bërë përshtypje një studim i Shoqatës Amerikane të Kardiologjisë i vitit 2016, që e keni përmendur në relacionin tuaj shumë të detajuar dhe ju falënderoj ju dhe ish-kolegun Deda, që fëmija nuk duhet të konsumojë më shumë se 24-25 gramë sheqer, që të përkthyer në gjuhën e përditshme familjare, janë 4-5 lugë çaji.

Unë e kuptoj që kjo është një sfidë, jo vetëm parlamentare, por e të gjithë shoqërisë, është sfidë për të sensibilizuar çdo familje shqiptare, se e dimë se si jetohet dhe si ushqehen njerëzit, që të tregohen shumë të kursyer te përdorimi i sheqerit, për të frenuar sa të mundemi rritjen drastike të këtyre sëmundjeve kronike.

Në një studim të qershorit të 2018-s, theksohet që sheqeri i tepruar sjell jo pak, por 8 dëmtime të rëndësishme në sistemin nervor qendror, pra pasojat janë të rënda në shëndet, por nuk kuptohen në momentin kur konsumohet sheqeri.

Ndaj, duke u bashkuar me kolegët, shpresoj që me miratimin e këtij projektligji dhe të këtyre ndryshimeve që keni propozuar, të na bashkohen të gjitha OJF-të që merren me fëmijët, të cilat kurrë nuk e kanë diskutuar këtë problem. Kanë ardhur për probleme nga më të ndryshmet këtu. Kemi bërë seanca të ndryshme dëgjimore për të ushqyerin, se si duhet ta fusim ushqimin në shkollë, por OJF-të asnjëherë nuk e kanë përmendur pijen energjike dhe pijet me sheqer, sepse jam e sigurt që kanë menduar kërcënimet më pas. Kjo është një kosto që ne duhet ta ndajmë të gjithë dhe nuk ka pse ta mbajë mbi supë vetëm një person.

Bravo ju qoftë, edhe një herë ju përgëzoj!

Kam një propozim të vogël, që, në fakt, e kam bërë edhe në vitet e mëparshme, meqenëse ju si Komision Ekonomie e diskutoni të parët buxhetin. Jam shumë e shqetësuar për shëndetin dentar të fëmijëve, ku një nga faktorët kryesorë që ndikon është sheqeri. Ne e ofrojmë falas parandalimin, shërbimin dhe kontrollin. Hapi i dytë, mjekimi, është shumë vështirë të realizohet. Ne e dimë si është situata, sepse është shëndeti publik ai që e ofron, me këto qendra, me stomatologët që janë akoma në sektorin publik, se e dimë që 90% e stomatologjisë është e privatizuar. Kjo pjesë që ofrohet në shëndetin publik për shëndetin dentar të fëmijëve, është shumë e kufizuar.

Ne mund të bëjmë një hap pozitiv, duke ofruar një shëndet dentar deri në mjekim bashkëkohor, siç mundohemi të bëjmë ne me fëmijët tanë, me tela, me... Ta fillojmë me një hap të vogël për fëmijët e familjeve me ndihmë ekonomike. Se si mund të realizohet kjo, mund të ketë projekte të ndryshme, edhe në kuadër të partneritetit... Ekzistojnë mënyra të ndryshme dhe shpresoj që në të ardhmen shëndeti dentar i fëmijëve të marrë këtë formë, sepse janë shumë studime që tregojnë se dëmtimi i shëndetit dentar të fëmijëve është pasojë për shumë sëmundje të tjera kronike.

Ju faleminderit!

Elisa Spiropali – Do të kërkoj mirëkuptimin tuaj, që t'i bëjmë shkurt diskutimet dhe të bëjmë pyetje koncize, që më pas të kalojmë në votim, duke qenë se një grup deputetësh ka një aktivitet tjetër.

Faleminderit!

Adelina Rista – Faleminderit!

Do të flas shumë shkurt.

Prezenca e një numri të madh deputetësh në këtë seancë dëgjimore tregon më së miri se sa e ndjeshme është kjo çështje. Mbi të gjitha dhe mbi gjithçka qëndron jeta dhe shëndeti i fëmijës.

Zoti Braçe, sinqerisht, ju falënderoj për këtë nismë ligjore!

Do ta prek çështjen aty ku e preku kolegia parafolëse, te guximi. Të ndërmarrësh një nismë të tillë ligjore, që prek shumë interesa, kuptohet, interesa të grupeve që kanë marketingun e pijeve energjike apo pijeve të gazuara me sheqer të shtuar, do guxim, por mbi interesat e këtyre grupeve qëndrojnë interesat e përgjithshme të shëndetit dhe jetës së fëmijës.

Prandaj, ju falënderoj dhe ju mbështes 100%!

E thashë edhe më lart, prezenca e kaq shumë deputetëve tregon më së miri mbështetjen për këtë nismë tuajën ligjore.

Besoj fort që, ashtu siç është bërë efecient ligji antiduhan, ashtu edhe ky ligj do të gjejë zbatueshmërinë e plotë. Kemi nevojë për sensibilizim të të gjithë shoqërisë. Në qoftë se kujdesi i fëmijës fillon që në barkun e nënës, në qoftë se kujdesemi për mirushqyerjen e nënës, sepse nëse nëna pi alkool, kjo ndikon te fëmija, nëse nena pi duhan, ndikon te fëmija, atëherë ky kujdes duhet edhe pas lindjes dhe gjatë rritjes së fëmijës, për të pasur një shëndet të mirë mendor dhe fizik të fëmijës.

Sinqerisht, ju admiroj dhe ju jap mbështetjen time maksimale!

Kuptohet, ne kemi nevojë për sensibilizim të të gjithë shoqërisë, si dhe për të parë recetën e ushqyerjes së fëmijëve tanë.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Zonja Dhima, më pas zoti Çela. Ju jeni brenda qarkut, prandaj faleni njëri-tjetrin!

Antoneta Dhima – Unë jam pjesë e Komisionit të Ekonomisë dhe nuk mund të rrija pa falënderuar kryetarin e komisionit, i cili këtë diskutim që ne po bëjmë sot, e ka bërë edhe në komision, pavarësisht se ne si komision e kemi diskutuar nga ana fiskale dhe sot jemi përpara një projekti, që diskutohet nga ana shëndetësore!

Në fakt, do të doja që sot të kishim një opinion nga institucionet përgjegjëse, të cilin nuk e kemi, por nënkryetarja e komisionit tha se ky informacion do të vijë në një moment tjetër.

Ajo që doja të dija nga ju, zoti kryetar, është: a mendoni se ky projektligj dhe këto ndryshime do të realizojnë qëllimin për të cilin ju i keni propozuar?

Erion Braçe – Zonja Dhima, ju mendoni që unë nuk luftoj për këtë gjë? Të jeni e bindur që unë do të luftoj që kjo të zbatohet deri në fund, pa asnjë lloj diskutimi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Faleminderit që ma dha fjalën vetë prezantuesi i ndryshimeve ligjore, se të ishte për ju të tjerët, nuk do ta kisha marrë asnjëherë!

Unë i përkas grupit të deputetëve të “Redbull Lushnjë”, që do të thotë se fëmijëve u porositim pije energjike dhe vetë pimë dhallë.

Kolegu Braçe është në detyrë të plotë me zonën elektorale që përfaqëson.

E falënderoj zotin Braçe, pasi kemi qenë të gjithë në hall për përdorimin e këtyre pijeve! Kjo nismë, ashtu si të tjerat, me përmirësimin e ligjeve, shpresoj të na bëjë bashkë, jo vetëm në këtë sallë, por deri në sallën e qeverisë, se në fund fare ajo do ta zbatojë. Ne do të flasim, do të votojmë, do të na vijë mirë, dikush nga ne tha se është me vonesë kjo nismë, sepse fëmijët janë rritur, por do t’i rriten nipërit dhe mbesat e me radhë... Por kjo nismë, pa qeverinë, pa trekëndëshin mësues-prindër-nxënës, pa biznesin (jo të gjuajë me shuplakë veten, por të kujdesët nga frika, që të mos ua japë fëmijëve tanë), nuk do të jetë e mundur.

Unë kam shumë besim dhe shpresë, sepse kjo qeveri është qeveri e iniciativave dhe është këmbëngulëse.

Ligji për alkoolin dhe ligji për duhanin kanë qenë prezentë, por këto vite e kanë dhënë efektin e tyre si ligje, saqë shpesh thonë: “Ky ligj është bërë tani”. Nuk është bërë tani, ligji ka qenë, por tani është zbatuar dhe ne si popull ligjin e mbajmë mend kur zbatohet. Unë besoj shumë...

Pa u zgjatur me teoritë dhe pyetjet provokuese, që i bën shoqja Neta kryetari të saj (dyshoj që kjo pyetje vjen nga paneli qendror), edhe unë i bashkohem kësaj nisme, jo thjesht me votë, por edhe me kontribut direkt.

Faleminderit!

Flamur Golemi – Faleminderit!

Desha ta falënderoj dhe ta përgëzoj kolegun Braçe!

Në fakt, pa i dhënë një optikë mjekësore problemit dhe nismës, teksa lexoja 14 rreziqet e konsumit të tepërt të pijeve energjike, sigurisht, shumë më të dëmshme janë problematikat që shkakton sheqeri dhe përdorimi i produkteve me sheqer për grupmoshën nën 16 vjeç.

Koleges Antoneta desha t’i them se me këtë projektligj është vënë një tullë e fortë në rritjen e shëndetshme të fëmijëve dhe të gjithë shoqërisë sonë.

Ju faleminderit për kurajën dhe ju përgëzoj, dhe besoj se të gjithë së bashku do të arrijmë t’i japim frymë kësaj nisme dhe këtij ligji!

Faleminderit!

Elisa Spiropali - Të nderuar kolegë, unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që të fillojmë me procesin e votimit.

Kourumin e kemi për të dyja komisionet. Unë gjykoj se duhet të kalojmë në votimin në parim dhe nën për nën po sot.

Diskutimi ishte produktiv, ne e kemi nisur projektligjin të institucionet përkatëse, nga të cilat nuk ka pasur propozime për ndryshime, prandaj besoj se e kemi rrugën e lirë për ta votuar edhe nën për nën.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Dakord.

Hedhim në votim në parim nismën për amendimin e ligjit nr. 9518, datë 18.04.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar”.

Falënderojmë zotin Braçe për këtë prezantim kaq shterues dhe produktiv për të dyja komisionet.

Kush është dakord? Të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

II - Kalojmë në votimin nën për nën.

Ismet Beqiraj - U bënë disa propozime; mbase ato duhen administruar dhe diskutuar.

Elisa Spiropali - Në momentin që do të diskutohet nën për nën, do të diskutojmë të ndryshuar me propozimin e bërë nga zonja Rista.

Atëherë, fillojmë votimin nën për nën.

Neni 1. Në titullin e ligjit pas fjalëve “nga përdorimi i alkoolit” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Besoj se duhet t’i lexoj nënet?

Milva Ekonomi - Jo, vetëm nënet që kanë ndryshime.

Elisa Spiropali- Po më thonë që është më mirë të lexohen nënet.

Neni 2. “Qëllimi i ligjit”, riformulohet si vijon: “Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar nëpërmjet përdorimit të tyre nga të miturit”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka Abstenim ? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

“Në nënin 2 “Objekti i ligjit” bëhen këto ndryshime: “1. Në paragrafin e parë pas fjalëve “të pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijet energjike”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë dhe i katërt me këtë përmbajtje: “Në kuptim të këtij ligji, pije energjike konsiderohen ato pije joalkoolike, në të cilat përmbajtja totale e kafeinës tejkalon sasinë 150 miligram për litër dhe që në përbërje të tyre kanë të paktën një ose shumë substance stimuluese, si: taurinë, dlukoronon, ylakton, guaranë, maltodekstrinë, xhensen, karnitinë, kreatinë dhe gingo bilova. Në kuptim të këtij ligji “pijet e gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar konsiderohen ato pije joalkoolike që përmbajnë sheqer, agjentë të tjerë ëmbëlsues ose aromatizues natyral ose artificial, si dhe acid ushqimor, përjashtojnë ujë mineral dhe ujërat e gazuara, lëngjet e frutave dhe pijet e bëra me qumësht ose produktet e qumështit”.

Në fakt, unë kam një sugjerim në pikën 2 të ligjit “në kuptim të ligjit pije energjike konsiderohen ...” kjo duket se mund të hyjë te përkufizimet, në vend që të jetë në ligj, meqë është shumë teknike.

Erion Braçe - Zonja Spiropali, a e dini pse e kemi bërë kaq teknike? Sepse gjatë të gjithë kohës që jemi marrë nga pikëpamja fiskale për të rritur barrën e tyre, ka pasur lojëra në njërën nga elementet. Pikërisht për këtë arsye e kemi marrë përkufizimin siç është përkufizimi i plotë i pijeve energjike dhe i pijeve me sheqer të shtuar, dhe e kemi vendosur *mot a mot*, me qëllim që të mos ketë lodra. E heq njëri nga etiketa, e heq tjetri nga etiketa, ul miligramët e njërës, ul të tjetrës dhe pastaj thonë që nuk hyjnë atje se është gjë tjetër kjo! Kjo lloj loje që është përsëritur për 4 vjet me radhë, mendoj se duhet ezauruar, duke e formuluar në këtë mënyrë.

Elisa Spiropali – Atëherë, e votojmë siç është propozuar. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 4. “Në nenin 3 “Reklama e pijeve alkoolike” në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve “e pijeve alkoolike” dhe “e përdorimit të alkoolit” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Ismet Beqiraj – Unë mendoj të shtohet fjalia “Pijet alkoolike, pijet energjike dhe të gazuara dëmtojnë shëndetin e të miturve deri në moshën 18 vjeç”, si për duhanin.

Erion Braçe- Unë e kuptoj shumë mirë këtë që thoni, por i vetmi problem është që ne për këtë kategori, për fëmijët, e ndalojmë fare. Nuk duhet të ketë etiketë fare për fëmijët. Deri në 18 – vjeç ky produkt është i ndaluar, i paligjshëm për t’u shitur për fëmijët, ndërkohë që ky produkt i adresohet më shumë se fëmijëve, moshës sonë. Vendosja në etiketë do të sillte një kontradiktë, që do ta bënte ligjin të pazbatueshëm. Kështu që më mirë qëndrojmë te ndalimi total i tregtimit për fëmijët dhe tek ajo që ju thatë, te reklama një orë para, një orë pas emisionit që i adresohet kësaj fashe.

Ismet Beqiraj- Kjo është psikologjike, sepse kur prindi i thotë fëmijës këtë mos e prek, këtë mos e ha, kjo të dëmton, fëmija në psikologjinë e tij mendon se qenka e dëmshme.

Elisa Spiropali - Besoj se shpjegimi i zotit Braçe ishte i qartë. Mund ta hedhim në votë.

Erion Braçe- Njëra prej kompanive, ajo që unë kam pare, ka zbatuar direktivën e Bashkimit Europian, ku thuhet që ndalohet konsumi për të mitur dhe për gratë shtatzënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ajo e duhanit është tjetër gjë.

Elisa Spiropali- Zonja Ekonomi po thotë që kanë bërë luftë me vite 150 vende për ta vendosur atë te duhani.

Erion Braçe - E kanë të shkruar në kanoçe që nuk rekomandohet për të miturit, edhe për gratë shtatzënë, ndërkohë që ne po e ndalojmë fare.

Elisa Spiropali- E hedhim propozimin në votë apo e propozojmë siç është? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. “Në nenin 4 “Ndalimi për përdorimin e alkoolit bëhen këto ndryshime: 1. Në titull dhe në paragrafin e parë pas fjalëve “e alkoolit dhe e pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje “Ndalohet ofrimi i pijeve alkoolike dhe energjike të miturve nga personi madhor që e shoqëron atë në vende publike”.

Erion Braçe- Është ai shqetësimi që u ngrit edhe këtu.

Elisa Spiropali - Po, i përgjigjet edhe shqetësimit të zotit Beqiraj.

Hedhim në votë nenin 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Në nenin 5 “Frekuentimi i lokaleve të natës”, kudo në nen pas fjalëve “pije alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

E hedhim në votë siç është.

Fjalën e ka zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Nuk e di për kinematë, sepse edhe kinematë frekuentohen shumë nga fëmijët dhe nga të rinjtë. A do të ishte me vend që ne të bënim një shtesë jo për pijet alkoolike, sepse nëpër kinema nuk kam parë pije alkoolike, por te pijet energjike të shtohet varianti “përveç lokaleve të natës dhe kinemave”.

Erion Braçe – Për pijet energjike dhe për pijet me sheqer, siç thuhet.

Po, patjetër mund ta vëmë.

Klodiana Spahiu – Të gjendet mënyra...

Erion Braçe – Jam dakord, edhe kinematë.

Ka plot vende që e kanë zgjidhur me atë që unë ju thashë, me përgjegjësinë sociale. Për shembull, po të hysh në një stadium europian, kudo që të kërkosh nuk ka birrë me përmbajtje alkooli, ka birrë pa alkool e ku di unë. Pse? Sepse duan të kontrollojnë ambientin. Duhet të ishte e njëjta gjë edhe për këtu, por atje të ofrojnë kovën me kokoshka dhe kovën me produktin. Ti shkon atje të shohësh një film me automatik, çfarë do të bësh më tej. Pra, del nga andej dhe bën si personazhi që pe në film. Prandaj, sipas mendimit tim, është mirë të vendoset për të dyja, edhe për kinematë të ndalohen pijet energjike dhe pijet me sheqer të shtuar.

Ndryshimin do ta bëjmë te neni 4, sepse nga pikëpamja teknike e rregullojnë ekspertët.

Neni 4 thotë: “Ndalime për përdorimin e alkoolit”, ndërsa ne do të themi “pijeve energjike dhe pijeve me sheqer të shtuar”. Pra: “Ndalohet shitja ose ofrimi falas i pijeve alkoolike të miturve apo konsumi i tyre në vende publike nga të miturit. Në kuptim të këtij ligji vend publik përfshin çdo njësi tregtare, bar restorant ose klub nate, kinema”.

Elisa Spiropali – Neni 4 thatë?

Erion Braçe – Jo neni 4 i ligjit, por i ligjit bazë. Pra, do të na duhet të ndërhyjmë, por teknikët duhet ta shohin.

Ne duhet të biem dakord për këtë gjë...

Elisa Spiropali – Dakord.

E hedhim në votë. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me ndryshimin.

Neni 7. Në nenin 7 “Detyrimi për kontroll të dokumentit identifikues” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1 dhe 3 pas fjalëve “pije alkoolike” shtohen fjalët “dhe pije energjike”.
2. Në pikën 3 në fund të fjalisë shtohen fjalët “dhe ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç”.

3. Në pikën 4 fjalët “tabela treguese” zëvendësohen me fjalët “tabelat treguese”.

Jeni dakord?

E hedhim në votë. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Në nenin 8 “Ndalimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore” bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe kudo në nen pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Në fund të nenit shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Ndalohej çdo lloj reklamimi i pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në institucionet arsimore për të mitur”.

Zonja Ekonomi, ka një propozim.

Milva Ekonomi – Unë kam një propozim që erdhi nga diskutimet që u bënë këtu, prandaj mendoj që në krye të paragrafit të nenit 8 të jetë: “Në nenin 8 ndalimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore parauniversitare dhe në qendrat e mbrojtjes sociale për fëmijë”.

Besoj se jeni dakord?

Elisa Spiropali – Hedhim në votë nenin 8 me ndryshimet e propozuara. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohej neni 8 me ndryshime.

Neni 9. Në nenin 9 “Ndalimi i publicitetit për pijet alkoolike në median vizive” në titull dhe kudo në nen pas fjalëve “i publicitetit për pijet alkoolike dhe konsumimit të pijeve alkoolike” shtohen fjalët “pijet energjetike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Erion Braçe – Këtu do të bëhet edhe ndryshimi që propozon profesor Beqiraj. Ne do të ndërhyjmë te neni bazë, të cilin do ta bëjmë dhe do t’jua sjellim. Do ta formulojmë në këtë mënyrë: “Gjatë 1 ore para emisionit dedikuar kësaj grupmoshe dhe 1 orë pas, ndalohej reklama e tyre”.

Elisa Spiropali – Dakord!

Erion Braçe – Ne do ta formulojmë dhe do t’jua sjellim, duke shtuar edhe këtë gjë.

Elisa Spiropali – Hedhim në votim nenin 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohej.

Neni 10. Në nenin 10 “Reklamat e pijeve alkoolike” në titull dhe kudo në nen, pas fjalëve “reklamë e pijeve alkoolike” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Hedhim në votë nenin 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohej.

Neni 11. Në nenin 11 “Kundërvajtjet administrative” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1, 2 dhe 3 pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “dhe pijeve energjike”.

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 2.1 dhe 2.2 me këtë përmbajtje:

2.1. “Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në njësitë tregtare, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë”.

2.2. “Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet apo klubet e natës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë”.

3. Në pikën 5 pas fjalëve “ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç”, shtohen fjalët “dhe ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç”.

4. Në pikën 5, pas fjalëve “i pijeve alkoolike” shtohen fjalët “pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Jam dakord me shtesat, por do të sugjeroja që te pikat 1 dhe 2 janë shtuar vetëm fjalët dhe jo penalitetet, por mendoj që këto të dyfishohen: nga 10 mijë deri në 20 mijë që është në ligjin aktual, të shkojnë nga 20 mijë deri në 40 mijë. Kjo ishte për pikën 1.

Te pika 2 që është nga 20 mijë në 30 mijë, gjithnjë për subjektet tregtare, të shtohet nga 30 mijë në 50 mijë.

Elisa Spiropali – Zoti Braçe, e ka fjalën.

Erion Braçe – Unë e kuptoj shumë mirë dëshirën e profesorit, por duhet të jemi proporcionalë. Masat që janë këtu janë masat që janë sot në fuqi për alkoolin dhe nuk janë të vogla, janë 100, 200, 300 dollarë. 300 dollarë për një akt të tillë mendoj se është e mjaftueshme, që të mos shkojmë në ekstreme.

Këto janë gjobat më të shtrenjta që ka sot Shqipëria, janë më shtrenjta se për shkeljet e qarkullimit rrugor. 300 dollarë është më e shtrenjtë sesa gjoba për një shkelje rrugore për mosvënie rripi, nuk e di se sa do të jetë ai për telefonin, por deri te rripi këto janë më të lartat. Pra, sipas mendimit tim janë proporcionale me aktin e të tjera me radhë.

Elisa Spiropali – Hedhim në votë nenin 11 siç është.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Në nenin 12 “Dispozitat për medien vizive”, pas fjalëve “pije alkoolike” shtohen fjalët “pije energjike dhe pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

E hedhim në votë nenin 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13 “Dispozita kalimtare”.

1. Radio-televizionet, mediet e shkruara publike ose private, si dhe agjencitë publicitare brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare, që kanë të bëjnë me pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

2. Për zbatimin e nenit 11, pikave 2.1 dhe 2.2, ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.

E hedhim në votë. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14 “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Përpara se ta votojmë ligjin në tërësi, kisha një pyetje për propozuesin. A ka efekte financiare ky ligj, që të jemi në rregull edhe me ministrinë?

Erion Braçe – Zero efekte financiare.

Elisa Spiropali – Hedhim në votim në tërësi ligjin. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zoti Braçe, si dhe të gjithë kolegëve!

Erion Braçe – Shumë faleminderit edhe juve, ju jam shumë mirënjohës! Për dy ndryshimet që ramë dakord, vajzat do t’ia sjellin sekretarisë suaj.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Suksese!

MBYLLET MBLEDHJA

